

LIGJ
Nr. 93/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE E IRLANDËS SË
VERIUT, QË PLOTËSON KONVENTËN EUROPIANE PËR EKSTRADIMIN,
TË VITIT 1957**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut, që plotëson Konventën Europiane për Ekstradimin, të vitit 1957, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.9.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10627, datë 9.10.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT, QË PLOTËSON KONVENTËN
EUROPIANE PËR EKSTRADIMIN, TË VITIT 1957**

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, në vijim të referuara si “Shtetet Kontraktuese”:

duke pasur në konsideratë të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor;

të ndëryjegjshme për garancitë sipas sistemeve të tyre përkatëse ligjore, të cilat i sigurojnë një personi të akuzuar të drejtën për një gjykim të drejtë, duke përfshirë të drejtën për gjykim nga një gjykatë e paanshme e krijuar me ligj;

duke dëshiruar të plotësojnë dispozitat e Konventës Europiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 (Konventa Europiane për Ekstradimin) dhe të lehtësojnë funksionimin e saj ndërmjet Shteteve Kontraktuese, në mënyrë të veçantë në lidhje me ekstradimin e shtetasve të tyre përkatës;

si rrjedhojë e deklaratës së bërë nga Shqipëria në lidhje me nenin 6(1) të Konventës Europiane për Ekstradimin dhe të përfshirë në instrumentin e saj të ratifikimit dhe të depozituar më 19 maj 1999, me qëllim që Shqipëria të refuzojë të ekstradojë shtetasit e saj, përveç nëse parashikohet ndryshe në një marrëveshje ndërkombëtare në të cilën Shqipëria është palë (Deklarata shqiptare);

duke synuar, në kuadër të dhe në përputhje me Deklaratën shqiptare, eliminimin e pengesave ligjore ndaj ekstradimit të shtetasve të shtetit të kërkuar, të kërkuar për ndjekje penale ose për kryerjen e një dënimi në shtetin kërkues, duke marrë masa për ekstradimin e këtyre shtetasve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Ekstradimi i shtetasve

1. Palët Kontraktuese bien dakord se neni 6(1) (a) i Konventës Europiane për Ekstradimin (e drejta për të refuzuar ekstradimin e shtetasve) nuk zbatohet ndërmjet tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre të ndërsjella, sipas Konventës.

2. Si rrjedhojë, ekstradimi nuk refuzohet për arsye se personi i kërkuar është shtetas i shtetit të kërkuar.

Neni 2
Procedurat e ekstradimit

1. Kërkesat për ekstradim shkëmbehen drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve qendrore; në emër të Republikës së Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Gjyqësore, në emër të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nga autoriteti qendror i Mbretërisë së Bashkuar. Njësia Ndërkombëtare kundër Kriminalitetit në Ministrinë e Brendshme.

Neni 3
Zbatime kohore

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për vepra penale të kryera para ose pas datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për kërkesat për ekstradim të marra para datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 5, kërkesat për ekstradim të marra para datës në të cilën Marrëveshja pushon së pasuri efekt, do të vazhdojnë të rregullohen nga kjo Marrëveshje, pavarësisht përfundimit të saj.

Neni 4
Zbatimi territorial

Kjo Marrëveshje zbatohet:

- a) për Republikën e Shqipërisë;
- b) i) për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut;
- ii) për ishujt Channel Islands dhe Isle of Man dhe për çdo territor tjetër për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit Mbretëria e Bashkuar është përgjegjëse dhe për të cilët zbatimi i Konventës Europiane për Ekstradimin është zgjeruar me marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 5
Ratifikimi, hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën të dyja Shtetet Kontraktuese kanë njoftuar njëri-tjetritin nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat e tyre përkatëse për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

2. Çdo shtet kontraktues mund të përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i dhënë njëri-tjetrit njoftim me shkrim. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo dispozitë e Traktatit të Ekstradimit ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, të nënshkruar në Tiranë, më 22 korrik 1926, që pavarësisht nga zbatimi i nenit 28(1) të Konventës Europiane për Ekstradimin, mbetet në fuqi (traktati i

mëparshëm), do të pushojë së pasuri efekt ndërmjet Palëve Kontraktuese, përveç në rastin e kërkesave të ekstradimit të marra para datës në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruar, duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë, në Tiranë, më 5 prill 2017, në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëllorj autentike.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PËR MBRETËRINË E BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT